



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 22 datë 28.01.2019

PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË PROKURORIT

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi u njoh me Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, nr. 88, datë 26.07.2018, Vendimin e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, nr. 89, datë 06.11.2018 dhe Urdhrin e prokurorit Njazi Seferi “Për ekzekutimin e vendimit penal nr. 89, datë 06.11.2018”, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë;

KONSTATOI:

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, nisur nga emision “Fiks –Fare” i televizionit “Top Channel”, datë 21.10.2016, ka regjistruar procedimin penal Nr. 235, datë 24.10.2016, në ngarkim të shtetasit Tom Dedaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, për veprën penale “korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal.

Me Urdhër nr. 271, datë 31.10.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm, është vendosur pezullimi nga ushtrimi i detyrës, për prokurorin Tom Dedaj, deri në përfundim të hetimeve të procedimit penal.

Në datën 24.04.2017, Prokuroria pranë Gjykatës Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, pas përfundimit të hetimeve ka dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, procedimin penal nr.235 të vitit 2016, në ngarkim të pandehurit Tom Dedaj.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.88, datë 26.07.2018, vendosi deklarinim fajtor të të pandehurit Tom Dedaj, për kryerjen e veprës penale të “Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” të parashikuar nga neni 319/c të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.

Gjithashtu Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në aplikim të neneve 30/1, 35, 44/2 të Kodit Penal, ka dhënë si dënim plotësues, heqien e së drejtës për të pandehurin Tom Dedaj, për të ushtruar funksione publike për 5 (pesë) vjet.

Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin Tom Dedaj dhe vënien e tij në provë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me kushtin që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.

Pas ankimit të të pandehurit Tom Dedaj kundër vendimit nr.88, datë 26.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me

Vendimin nr.89, datë 06.11.2018, ka ndryshuar akuzën për të pandehurin dhe ka vendosur, Deklarimin fajtor të të pandehurit Tom Dedaj për kryerjen e veprës penale të “ Moskallzimit të krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe dënimin me 1 (një) vit burgim.

Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin Tom Dedaj dhe vënien e tij në provë për një periudhë 2 (dy) vjeçare me kushtin që giatë kohës së provës të mos kryeje vepër tjetër penale.

Gjithashtu Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, në aplikim të neneve 30/1, 35/2, 44/2 të Kodit Penal, ka dhënë si dënim plotësues, heqien e së drejtës për të pandehurin Tom Dedaj, për të ushtruar funksione publike për 1 (një) vit.

Për sa më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 148/d, pika 2, gërma “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Shkarkimin nga detyra të prokurorit Tom Dedaj, bazuar në vendimin e formës së prerë nr. 89, datë 06.11. 2018 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë.
2. Me këtë Vendim të njihet Prokurori i Përgjithshëm, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër dhe z. Tom Dedaj.
3. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

GENT IBRAHIMI

Kryetar

ALFRED BALLA

Zy/Kryetar

ANTONETA SEVDARI

Anëtar

ARBEN DOLLAPAJ

Anëtar

BESNIK CANI

Anëtar

GENTJAN OSMANI

Anëtar

KOSTAQ BELURI

Anëtar

SANDËR BECI

Anëtar

NURIHAN SEITI

Anëtar

TARTAR BAZAJ

Anëtar